



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 02/L-52 Mbi edukimin parashkollor, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 duke vendosur sipas kërkesës së Drejtoreshës së QEAP "Çerdhja " Lipjan të datës 06.10.2021, Kryetari Komunës merr :

VENDIM

I. **LIROHEN**, nga pagesa e tarifave për qëndrim ditor (participim) në institucionin për edukimin dhe arsimimin parashkollor publik –QEAP "Çerdhja" – Lipjan të gjithë prindërit për fëmijët e tyre për muajin shtator të vitit 2021.

II. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

Arsyetim

Me datë 06.10.2021 kemi pranuar kërkesën e Drejtoreshës së QEAP "Çerdhja" në Lipjan e cila ka kërkuar edhe në emrin e këshillit të prindërve lirim nga pagesa e tarifave për muajin shtator të vitit 2021 pasi fëmijët nuk kanë vijuar aktivitetet e tyre përshkak të ndërprerjes së procesit të punës në këtë institucion .

Pas shqyrtimit të kërkesës së lartëcekur u vendos për lirim nga pagesa e tarifave për muajin shtator përshkak se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 Nr. 01/35 të datës 12.09.2021 është pezulluar aktiviteti mësimor në institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar, duke përfshirë edhe institucionet e arsimit parashkollor dhe të qëndrimit ditor deri me datën 26 shtator 2021 dhe fëmijët nuk kanë pasur mundësi të vijnë aktivitetet e tyre të përditshme në këtë Institucion në këtë periudë kohore .
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet
Drejtoratit për Arsim
Institucionit parashkollor publik QEAP "Çerdhja" Lipjan

INr. 400 - 618 29
Lipjan, më 08.10.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

